



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit

15.07.2024

Nr.07-Zyrtarisht

Në bazë Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016, neni 11 dhe kërkesave të SHML-së dhe IAAP- së , Drejtoria Komonale e Arsimit në Deçan shpallë këtë:

### FTESË PËR OFERTË

Për organizimin e Ekskursioni në Shqipëri, më maturantë të dy shkollave të mesme të larta:

1. SHML- Gjinnazi - "Vëllezërit Frashëri" në Deçan;
2. IAAP - "Tafil Kasumaj" në Deçan.

### Ekskursioni do të jetë pesë ditë ( katër netë akomodimi).

Agjensioni duhet të plotësojë këto parakushte:

1. Të ketë licencë valide;
2. Të ketë kontroll teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore;
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve;
4. Autobusët të jenë komfor dhe më klimë;
5. Të mos ketë referenca negative;
6. Të ofrojë dëshmi për shëndetin fizikë dhe mendor të ngasësve të autobusëve;
7. Të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune si dhe diplomë të mjekut të angazhuar);
8. Agjensioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e caktuar të ekskursionit;
9. Të posedojë dokumentacionin (licencë), e agjencionit të akreditimit të ushqimeve për vendqëndrimin e nxënësve;
10. T'i mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasave, si dhe shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike;
11. T'i mbulojë shpenzimet për një zyrtarë të DKA-së ( Monitorues gjatë gjithë kohës, për pesë ditë radhazi, për dy shkollat.
12. T'i mbulojë shpenzimet për një përfaqësues të Këshillit të Prindërve.
13. Ekskursioni do të zhvillohet në shtetin shqiptar, pikë qëndrimi do të jetë Durrësi;
14. Do të ofrohen tre shujta ditore (mëngjes, drekë dhe darkë);
15. Do të vizitohen këto qendra: Shkodra, Lezha, Tërana, Kruja, dhe Berati – (Gjinnazi);
16. Do të vizitohen këto qendra: Kruja, Durrësi, Berati, Tërana, Lezha. – (IAAP).

Ofertuesi ka për obligim të përcaktojë se për cilën shkollë oferton.

Oferta do të shqyrtohen për secilën shkollë në mënyrë të veçantë, pa u ndikuar nga ofertat e shkollave tjera, objekte të kësaj oferte.

Kriteret për përzgjedhjen e kompanisë janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016.

Kompanitë fituese, do të monitorohen nga DKA-ja.

**Afati i ofertës është 7 ditë, nga dita e shpalljes.**

Ofertat protokollohet në zyrën pritëse, zarfa e mbyllur, pa u protokolluar dokumentacioni, pastaj dorëzohen në zarfe të mbyllur (personalisht) në zyrën e DKA-së në katin e parë nr.17".

**Data e fundit e aplikimit .**

**Hapja e ofertave bëhet më datë: 23.07.2024 ( ditë e Martë ora 17:00), në Drejtorinë Komonale të Arsimit në Deçan, në zyrën numër 10-të, ne prani të komisionit dhe ofertuesve.**

	DALESE - DEÇANA - DEÇAN
	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
	OPSTINA DEÇAN - MUNICIPALITY OF DEÇAN
Nr. 07	22368
07	15.07.24

